

<http://play.mrt.com.mk/play/40094?fbclid=IèAR34n6yMJ-KA-SHqu0c7bfsbxe44-RymczlxAN-mP2x6SbxHQ-1LofG-89k>

25.5.2020

Titulli: Diabeti – rreziku i dytë më i madh për koronavirusin

Askush nuk mund të thotë se kush është në radhë, por sipas të gjitha statistikave të vendit dhe ato botërore, diabetikët bëjnë pjesë në grupin më të rrezikuar prej koronavirusit. Beteja e tyre është të mos regjistrohen në listën e të sëmurëve, kanë frikë se nëse gjenden në atë listë, lehtë mund të përfundojnë fatalisht.

Bojan Kirov është diabetik prej moshës dyvjeçarë. Jeton 42 pranvera në këtë gjendje. Këtë javë për herë të parë pas dy muaj e gjysmë ka filluar të dalë nga shtëpia dhe të kryejë obligimet e përditshme. Thotë se për atë dhe të gjithë njerëzit e tjerë me sëmundjen e sheqerit, rekomandimet për mbrojtje janë si një bibël.

Deklaratë: Bojan Kirov – diabetik

“Nipërit e mi nuk i kam përqaftuar thuajse dy muaj e gjysmë ose tre, vijnë te ne shumë rrallë. Qëndrojmë në distancë edhe pse janë anëtarët më të ngushtë të familjes. Motrën dhe dhëndërin gjithashtu nuk i kam parë nga afër. I kamë parë, por nuk është ajo që duhet të ishte.”

Përditshmëria ka ndryshuar për secilin, por me lehtësimin e masave, te kjo kategori e njerëzve frika dhe kujdesi rriten.

Numri i njerëzve që ndajnë fatin e Bojanit nuk është i vogël. Sipas statistikave të Komisionit Kombëtarë për Diabet, 123.750 persona jetojnë me këtë gjendje, prej tyre 40.000 janë me terapi insulinë. Ndërkaq prej numrit të përgjithshëm, rreth 300 pacientë janë fëmijë.

Me sheqerin nuk jeton vetëm ai që është i sëmurë, por e tërë familja. Biljana është nënë e një tinxhereje 16 vjeçare, e cila prej kur ishte dy vjeçe është me terapi insulinë. Derisa vajza e saj rri në shtëpi, është e kujdesshme se si ajo të jetojë me diabet.

Deklaratë: Biljana Zunzurovska – prind i fëmijë me diabet

“Sigurisht që kamë frikë të mos sëmuret, të mos ketë diçka komplikime, mirëpo nëse respektojmë masat, mendoj se do të kalojë kjo.”

Ekzistojnë dy grupe themlore të diabetit. Tipi 2, që është forma më e shpeshtë dhe e fituar gjatë jetës dhe Tipi 1 që është diagnostifikuar zakonisht në fëmijërinë e hershme.

Stend up:

Nga numri i përgjithshëm i të vdekurve nga koronavirusi në vend, 22 pacientë kanë qenë me diabet. Sëmundja e sheqerit është e dyta për rrezikshmërinë nga Covid-19 sipas statistikave të deritanishme. Këto të dhëna janë shqetësuese për personat që jetojnë në këtë gjendje, por sikurse edhe me të gjitha sëmundjet tjera edhe me Covid-19 ekzistojnë më shumë variacione për rrezik.

Grafikë:

Mosha është faktori kryesor i rrezikut. Ata nën 40 vjetë janë më pak të rrezikuar. Studimet tregojnë se personat me diabet të Tipit dy janë në rrezik më të madh. Personat mbipeshë janë në rrezik më të madh, pa dallim nëse janë të Tipit 1 apo 2. Rregullimi i papërshtatshëm i sheqerit në gjakë shton rrezikun, gjithashtu, jo më pak i rëndësishëm është edhe tensioni i gjakut.

Endokrinologu Taner Hasan, nga Spitali "8 Shtatori", thotë se në këtë periudhë ka parë situata më të lehta dhe më të rënda të diabetikëve që luftojnë më virusin.

Deklaratë: Dr. Taner Hasan, endokrinolog

“Pacientët me diabet nuk janë vetëm me diabet, ata kanë edhe komorbiditete të tjera, më shpeshë kanë komplikime kardiovaskulare. Nuk ka diabetik që nuk ka problem me zemrën ose me sistemin kardiovaskular. Gjithashtu kanë edhe tension të lartë të gjakut dhe me profilin lipid. Kanë problem edhe me dobësinë e zemrës. Megjithatë kur do t’i përmbledhim të gjitha këto komorbiditete, përqindja e fatalitetit e vet sëmundjes dhe rreziku për shërim spitalor është shumë më i madh sesa popullsia e shëndoshë, që është 4 deri 6 herë me nevojë më të madhe për shërim në spital.

Mjeku Hasan thekson se diabetikët nuk guxojnë të presin, me paraqitjen e simptomeve të para, patjetër duhet të kërkojnë ndihmë mjekësore.